



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1861 Prot

Tiranë, më 21/11/2019

REKOMANDIM

Nr. 53, datë 21/11/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <http://punetejashtme.gov.al/programi-i-transparences-2/>, të Autoritetit Publik "Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore, menu-në “Programi i transparencës”, në të cilin janë ndërlidhur dy nënrubrika “Informacion për publikun” dhe “Transparenca financiare”.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pjesërisht të linkuara në programin e transparencës, si dhe rezulton se disa informacione nuk janë të përditësuara.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

c) informacion për procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të

drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por, të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;

2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 21 . 11 .2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi




Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme – datë 4.11.2019


Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: <http://punetejashtme.gov.al/programi-i-transparences-2/>

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “Programi i transparencës”, në të cilin janë ndërlidhur dy nënrubrika “Informacion për publikun” dhe “Transparenca financiare”.

Nga monitorimi rezulton se, Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 datë 22.01.2015 të Komisionerit. Gjithashtu rezulton se kategoritë e informacionit të programit model të transparencës, janë pjesërisht të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse, si dhe një pjesë e informacioneve të bërë publik kanë mbetur të pa përditësuar.


7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Informacioni i detyrueshëm për tu publikuar sipas kësaj pike, rezulton publikuar dhe i ndërlidhur me programin e transparencës;







7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës, mungon informacioni mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankesë;**



7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare të autoritetit si dhe është i ndërlidhur me programin e transparencës;**

The screenshot shows the website of the Ministry of Europe and Foreign Affairs (MINISTRIA PËR EVROPEJË DHE PUNËT E JASHTME). The page is titled "KONTAKT" (CONTACT) and provides contact information for the Coordinator of the Right to Information.

Koordinatori
 Petri Musa
 Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore
 Drejtoria e Burimeve Njerëzore
 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
 Tel Zyrë: 042364090-090 042364090 ext 149
 email: petri.musa@mfa.gov.al
 Orari punës nga e hëna të enjte ora 9:00-16:00 të Premten ora 9:00-14:00
 Qëndrojmë të detyrues me dije se Koordinatori nuk mund të japë informacione konsullore të cilat do t'i jepin në punët e jashtme gov.al adresë kontakti


The screenshot also shows a table with information about the procedures for the right to information:

Informacioni për	Neni	Kërkesa me	Vazhdimshmëri	Ne faqen zyrtare	Koordinatori
procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e zakonshme të vendimit përkatës.	7.1.ç	shkrim, shprehur me fotokopje të kartës së identitetit ose me postë ose postë elektronike	ne faqen zyrtare	zyrtare të MEPI dhe në kërshin e informacionit në zyrën e prapës së publikut http://punete.jashtme.gov.al/formulari	
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatit për të drejtën e informimit	Neni 7.1.ç	Ministria "Zhan Dark" Nr 6 Tirane	Nga e Hëna në të Premte, ora 10-16	Ne faqen zyrtare të MEPI dhe në kërshin e informacionit në zyrën e prapës së publikut	Koordinatori Petri Musa 042364090 ext 149
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes kompetencave të	Neni 7.1.d	Me emërim me VKM ose DAP-i	Kur krijohen vende vakante	Ne faqen zyrtare të DAP	Drejtorja Burimeve Njerëzore pas miratimit nga Departamenti

7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni nuk është i publikuar në faqe por në tabelën e programit të transparencës jepet një përshkrim i shkurtër lidhur me procedurat e rekrutimit në përgjithësi dhe jo specifike;**

7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. Në faqen zyrtare të autoritetit është publikuar plani strategjik i auditimit të brendshëm, mungojnë raportet e KLSH;

The screenshot shows the official website of the Ministry of Foreign Affairs and European Integration of North Macedonia. The header features the ministry's logo and name in both Macedonian and English. Below the header is a navigation menu with links to various sections. The main content area is titled 'RAPORTE' (Reports) and displays a list of reports for the year 2016 and the period 2016-2020. The website is in Macedonian, and the browser's address bar shows the URL 'mfa.gov.mk'. The browser's address bar also shows several open tabs, including 'Informacioni', 'Formulare', 'Ligjendite', 'Publikime', 'Call for Applications', 'Kontakt', and 'Responzi'.



7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është pjesërisht i publikuar;**

Programi buxhetor		Buxheti 2019	
Buxheti i MPPJ		2,145,500	
Shpenzimet buxhetore			
1. Përkrahja e Ministrisë së Administrimit			215,000
2. Mbrojtja e shërbimeve të shërbimit			2,410,000
3. Aktiviteti i shërbimit të MPPJ			207,500
4. Mbrojtja e shërbimeve të shërbimit të integruar			142,000

Programi buxhetor i shërbimeve të shërbimit të integruar		Buxheti 2019	
Buxheti i MPPJ për vitin 2019		2,145,500	
Shpenzimet buxhetore			
1. Përkrahja e Ministrisë së Administrimit			215,000
2. Mbrojtja e shërbimeve të shërbimit			2,410,000
3. Aktiviteti i shërbimit të MPPJ			207,500
4. Mbrojtja e shërbimeve të shërbimit të integruar			142,000
Buxheti i MPPJ për vitin 2019		2,145,500	

7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik

Informacioni i publikuar sipas kësaj kërkesë të ligjit nuk është i përditësuar (viti 2018);

Informacioni është i publikuar në programin e transparencës:

programi-transparencës-2-2018-1-4.pdf

për publikun	7.1.f	dok për jashtë vendit, Studi me në Arkiv.	në faqen zyrtare të MPJ	zyrtare të MEPJ <a href="http://www.punetes
poshtme.gov
.al">www.punetes poshtme.gov .al	
--------------	-------	---	-------------------------------	--	--

		Vërtetime për vjetërsi në punë basike me pagën			
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7.1.h	Sekretariat Qendror mban regjistrin për të gjitha shikuesat e ardhura dhe te matura dhe një kopje arshivohet sipas ligut për arkivat	Vazhdimisht informacioni që behet publik pa pagesë është atë pasqyrat në faqen zyrtare te MPJ		Drejtori Arkivit Koordinatori
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas	Neni 7.1.i	Kërkesat, e përgjigjet	Data e ardhjes dhe kthimit	Në faqen zyrtare të	

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - Informacioni i publikuar nuk është i përditësuar (përditësimi i fundit në muajin dhjetor 2018);


regjistr-2018.pdf

1/3

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË MPJ
April 2019 - Dhjetor 2018

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
1.	15.01.2018	Vërtetim page	17.01.2018	Informim	Falaz
2.	16.01.2018	Vërtetim page	19.01.2018	Informim	Falaz
3.	18.01.2018	Vërtetim page	21.01.2018	Informim	Falaz
4.	22.01.2018	Vërtetim pensioni	25.01.2018	Informim	Falaz
5.	19.01.2018	Vërtetim pensioni	21.01.2018	Informim	Falaz
6.	23.01.2018	Vërtetim për leje vjetërs	24.01.2018	Informim	Falaz
7.	25.01.2018	Vërtetim për leje vjetërs	26.01.2018	Informim	Falaz
8.	29.01.2018	Vërtetim leje e zakonshme	30.01.2018	Informim	Falaz
9.	29.01.2018	Vërtetim leje e zakonshme	30.01.2018	Informim	Falaz
10.	01.02.2018	Vërtetim page	03.02.2018	Informim	Falaz
11.	06.02.2018	Vërtetim page	08.02.2018	Informim	Falaz
12.	06.02.2018	Vërtetim pensioni	09.02.2018	Informim	Falaz
13.	09.02.2018	Vërtetim për pension	11.02.2018	Informim	Falaz
14.	09.02.2018	Vërtetim si punonjës	10.02.2018	Informim	Falaz
15.	12.02.2018	Vërtetim si punonjës	14.02.2018	Informim	Falaz
16.	12.02.2018	Vërtetim si punonjës	13.02.2018	Informim	Falaz
17.	12.02.2018	Vërtetim si punonjës	14.02.2018	Informim	Falaz
18.	12.02.2018	Vërtetim për pension	14.02.2018	Informim	Falaz
19.	13.02.2018	Vërtetim që shka mase disphore	15.02.2018	Informim	Falaz
20.	14.02.2018	Vërtetim për pension	17.02.2018	Informim	Falaz
21.	16.02.2018	Vërtetim për leje	18.02.2018	Informim	Falaz
22.	19.02.2018	Vërtetim për leje	21.02.2018	Informim	Falaz
23.	19.02.2018	Vërtetim për pension	20.02.2018	Informim	Falaz
24.	19.02.2018	Vërtetim për leje	20.02.2018	Informim	Falaz
25.	21.02.2018	Vërtetim për pension	22.02.2018	Informim	Falaz
26.	21.02.2018	Vërtetim për pension	23.02.2018	Informim	Falaz
27.	26.02.2018	Vërtetim për pension	27.02.2018	Informim	Falaz
28.	26.02.2018	Vërtetim për pension	27.02.2018	Informim	Falaz
29.	28.02.2018	Vërtetim për pension	01.03.2018	Informim	Falaz
30.	28.02.2018	Vërtetim për pension	01.03.2018	Informim	Falaz
31.	01.03.2018	Informacion për pushim nga punë	05.03.2018 12.03.2018	Informim Platforma	Falaz
32.	02.03.2018	Vërtetim punë	04.03.2018	Informim	Falaz

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh- Informacioni është i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;



7.1.1 çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik . Informacioni është i publikuar faqe por nuk është ndërlidhur në tabelën e programit model të transparencës.

